



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E UJITJES DHE KULLIMIT
LEZHË

**RAPORT MONITORIMI
I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT TË
DREJTORISË SË UJITJES DHE KULLIMIT LEZHË
PËR PERIUDHËN
JANAR – DHJETOR 2025**

I. PËRMBLEDHJE

Plani i Integritetit përbën një instrument të luftës kundër korrupsionit, i cili i shërben institucionit në identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e tërësisë së risqeve që çenojnë integritetin.

Plani i Integritetit të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë për vitin 2025, përfshin një analizë të vlerësimit të risqeve të integritetit në institucion, si dhe parashikon masa konkrete për zbatim, me qëllim përmirësimin e efikasitetit, transparencës, llogaridhënies, rritjen e besueshmërisë publike, si dhe arritjen e objektivave strategjike e specifike të institucionit. Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve është kryer kryesisht në fushën e menaxhimit financiar, transparencës, burimeve njerëzore, si dhe fusha të tjera të veprimtarisë së institucionit.

Objektivat që synohet të arrihen nëpërmjet Planit të Integritetit janë si vijon:

- Mjedisi i brendshëm rregullator dhe institucional forcimi i transparencës dhe monitorimi i vazhdueshëm, duke siguruar rritjen e besueshmërisë publike;
- Burime njerëzore të kualifikuara, të qëndrueshme dhe me trajnime të përshtatshme për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit;
- Përmirësimi i kuadrit rregullator, me qëllim forcimin e integritetit në institucion.

DUK Lezhë ka hartuar raportin e monitorimit për periudhën janar-dhjetor 2025, mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente. Monitorimi i Planit të Integritetit është një fazë e rëndësishme, për arsye se shërben për të vlerësuar nëse risqet e identifikuara janë menaxhuar në mënyrë efektive, si dhe për të konstatuar nëse janë realizuar aktivitetet dhe masat e parashikuara në planin e veprimit.

Raporti monitorimit të Planit të Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, jep të dhëna mbi zbatimin e objektivave dhe masave të parashikuara për periudhën e kërkuar, progresin e zhvilluar në kuadër të rritjes së transparencës, si dhe masat e ndërmarra për plotësimin dhe rishikimin e legjislacionit në fuqi, me qëllim përmirësimin dhe forcimin e integritetit.

II. QASJA VLERËSUESE

Raporti monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit përmban një analizë të përgjithshme të performancës institucionale për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit, ku përcaktohet niveli i realizimit të masave të parashikuara në plan, si dhe hapat konkretë që janë ndërmarrë nga sektoret përgjegjëse për përmbushjen e tyre brenda afatit.

III. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Raporti monitorimit është hartuar në bazë të kontributit të Sektorëve të DUK të cilët kanë patur të parashikuara masa për zbatim për periudhën e kërkuar. Secili Sektor ka raportuar mbi statusin e realizimit të masave, nëse janë realizuar plotësisht, vijojnë të jenë në proces, dhe veprimet konkrete që janë ndërmarrë për përmbushjen e tyre. Të dhënat e këtij raporti janë mbledhur nga Koordinator i Integritetit, në përmbushje të rolit të tij, si personi i caktuar për hartimin e raportit të monitorimit.

Personat përgjegjës që kanë raportuar janë si më poshtë vijon:

- Sektori Financës, Donika Zefi;
- Sektori Teknik, Ing. Marsuela Lleshi
- Sektori Hidrovor – Makineri, Ing. Ilmi Dushkaj
- Sektori Shkodër , Ing. Shpresa Kodra
- Sektori Kukës , Beqir Mulaj

IV. GJETJET E RAPORTIT

Monitorimi i zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Integritetit është një hap i rëndësishëm për të garantuar integritetin institucional. Konkretisht nëpërmjet hartimit të raportit të monitorimit synohet:

- Mbikqyrja e vazhdueshme e nivelit të zbatimit të masave të parashikuara në plan;
- Forcimi i llogaridhënies dhe transparencës në institucion, për të siguruar rritjen e besueshmërisë publike;
- Rishikimi dhe plotësimi i vazhdueshëm i legjislacionit ligjor në fuqi, me qëllim përmirësimin dhe forcimin e integritetit.

STATUSI I ZBATIMIT TE OBJEKTIVAVE PER PERIUDHEN JANAR-DHJETOR 2025

OBJEKTIVI 1

“ Arritja e rezultateve optimale dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe të menaxhimit të sistemit të ujitjes ”

Arritja e rezultateve optimal dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe të menaxhimit të sistemit të ujitjes përbën një ndër objektivat kryesor që synohet të përmbushet. Ky objektivi

paraqet një rëndësi thelbësore, për arsye se nëpërmjet këtij procesi plotësohen nevojat e fermerëve për ujë për ujitje dhe rritet besueshmëria publike mbi veprimtarinë e DUK Lezhë.

Me qëllim përmbushjen e këtij objektiv gjatë periudhës raportuese, janë realizuar masat si vijon:

- Është arritur përdorimi eficient i fondeve të akorduara nga buxheti i shtetit për përmirësimin e administrimit të sistemit të ujitjes duke ndjekur me përpikmëri ligjet dhe udhëzimet e buxhetit dhe Ligjin për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytja si dhe udhëzime të tjera në mbështetje të tyre.
- Ka patur një bashkëpunim të gjithë sektorëve të DUK me njëri tjetrin si dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet e pushtetit vendor dhe fermerët në kuadër të identifikimit të nevojave kryesore dhe emergjente për ndërhyrjen në rehabilitim e sistemeve të ujitjes. Janë marrë parasysh kërkesat e bashkive dhe kërkesat e fermerëve në hartimin e listave për ndërhyrje me punime. Në fillim të vitit janë dërguar pranë bashkive listat e objekteve ku do të ndërhyhet me punime me qëllim që të rakordohen ndërhyrjet në objekte për të realizuar funksionalitetin e infrastrukturës së ujitjes dhe për të garantuar furnizimin me ujë të fermerëve gjatë gjithë sezonit të ujitjes. Sa me sipër listojme si me poshtë:
- Drejtori ka nxjerrë urdhërin nr.35, dt.22.04.2025 për ngritjen e grupit të punës mbi inspektimin e zbatimit të punimeve në objektet e investimeve në ujitje për objektet si më poshtë:
 1. Rehabilitim i Kanalit Ujites Shelqet-Pistull, L=4.555 km
 2. Kanali Ujites U-13 Kurbin
 3. Kanali Ujites U-13 Kurbin
 4. Rehabilitim i kanalit Ujites U-15 Kurbin , L=11 km
- Drejtori ka nxjerrë urdhërin nr.42, dt.19.05.2025 për ngritjen e grupit të punës mbi inspektimin e gjendjes se rezervuarit Shtoder.
- Drejtori ka nxjerrë urdhërin nr.65, dt.27.06.2025 për ngritjen e grupit të punës mbi verifikimin e gjendjes se objektit, Kanali ujites Partitori 121- Barbullush , mbi situaten problematike qe ka krijuar si pasoje e thyerjes se tij.
- Ështe mbajtur procesverbali nr.343/1 prot , date 27.06.2025 mbi verifikimin e demtimit te tij .
- Drejtori ka nxjerrë urdhërin nr.87/1, dt.11.08.2025 për ngritjen e grupit të punës mbi verifikimin e objekteve te cilet kane nevoje per hartimin e projekteve te zbatimit.
- Drejtori ka nxjerrë urdhërin nr.89, dt.15.08.2025 për ngritjen e grupit të punës mbi inspektimin e objekteve ku ushtron aktivitet DUK Lezhe .
- Drejtori ka nxjerrë urdhërin nr.95, dt.15.09.2025 për ngritjen e grupit të punës per kontrollin e argjinaturave , Kanaleve te Ujerave te Larta dhe diges se rezervuarit Shtoder.
- Ështe mbajtur procesverbali , date.1.10.2025 mbi gjendjen e Diges se rezervuarit Shtoder .

OBJEKTIVI 2

“ Arritja e rezultateve optimale dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe të menaxhimit të sistemit të kullimit ”

Me qëllim përmbushjen e këtij objekti gjatë periudhës raportuese, janë realizuar masat si vijon:

1. Zhvillimi i sistemit të kullimit

- Është arritur përdorimi eficient i fondeve të akorduara nga buxheti i shtetit për përmirësimin e administrimit të sistemit të kullimit duke ndjekur me përpikmëri ligjet dhe udhëzimet e buxhetit dhe Ligjin për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmytja si dhe udhëzime të tjera në mbështetje të tyre.
- Ka patur një bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet e pushtetit vendor dhe fermerët në kuadër të identifikimit të nevojave kryesore dhe emergjente për ndërhyrjen në rehabilitim e sistemeve të kullimit. Kanë patur prioritet ndërhyrja në objekte ku funksionaliteti i tyre shërben edhe si parakusht për ujitjen e duhur .Në fillim të vitit janë dërguar pranë Bashkive listat e objekteve ku do të ndërhyhet me punime me qëllim që të rakordohen ndërhyrjet për të realizuar funksionalitetin e infrastrukturës së kullimit, ujitjes dhe mbrojtjes nga përmytjet në tërësinë e tij.
- Drejtori ka nxjerrë urdhërin nr.87/1, dt.11.08.2025 për ngritjen e grupit të punës mbi verifikimin e objekteve te cilet kane nevoje per hartimin e projekteve te zbatimit.
- Drejtori ka nxjerrë urdhërin nr.89, dt.15.08.2025 për ngritjen e grupit të punës mbi inspektimin e objekteve ku ushtron aktivitet DUK Lezhe .

2. Administrimi i sistemit të kullimit

- Janë marrë masa për sigurimin e funksionimit të sistemit të kullimit nëpërmjet kryerjes së punimeve të pastrimit të kanaleve kulluese me eskavatorë.
- Sektori Teknik , në bashkëpunim me Sektorin Shkodër dhe Sektorin Hidrovor Makineri ka bërë identifikim e nevojave për riparime dhe shërbime të makinerisë së rëndë , të cilat janë prokuruar duke bërë të mundur që të gjithë eskavatoët të riparohen dhe të jenë në gjendje pune.
- Ka patur kontrolle në objekte ku punohet çdo ditë nga ana e inxhinierëve , teknikëve për të bërë të mundur përdorimin me efikasitet të kohës së punës . Kjo ka bërë të mundur të shmangen abuzimet me shpenzimin e karburantit nga ana e manovratorëve dhe të realizohen volumet e punës të parashikuara. Janë mbajtur procesverbale të verifikimeve dhe kontrolleve në objekte .Janë bërë takime të vazhdueshme pune nga ana e drejtorit dhe specialisteve te institucionit me punonjësit e mirëmbajtjes dhe punonjëseve me kontratë të përkohshme pune të cilët raportojnë çdo ditë të premtë mbi gjendjen e objekteve dhe konstatimet në terren .

OBJEKTIVI NR. 3

“ Arritja e rezultateve optimale dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe të menaxhimit të sistemit të mbrojtjes nga përmbytjet ”

- Është bërë identifikimi i veprave të mbrojtjes nga përmbytjet duke i renditur ato sipas riskut potencial për të përcaktuar nevojat për ndërhyrje dhe për të mbrojtur zonat e populluara nga përmbytjet.
 - Janë kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme argjinaturat dhe KUL duke bërë të mundur të ndërhyhet në kohë dhe shmangur rrezikun e përmbytjeve.
 - Janë dërguar në MBZHR listat e objekteve sipas prioriteteve dhe janë akorduar fonde nga buxheti për ndërhyrje në investime . Këto investime kanë patur impakt të rëndësishëm në mbrojtjen e zonave nga përmbytjet.
 - Drejtori ka nxerrë urdhërin nr.35, dt.22.04.2025 për ngritjen e grupit të punës mbi inspektimin e zbatimit të punimeve në objektet e investimeve në ujitje për objektet si më poshtë:
 1. Mbrojtje bregu nga gerryerjet e lumit Drin ne Bahçallek, Shkoder
 - Drejtori ka nxerrë urdhërin nr.99, dt.21.10.2025 për ngritjen e grupit të punës mbi verifikimin ne vend te problematikave te shprehura ne kerkesen e Bashkise Shkoder per zonen e lagjes Bahçallek , pergjate lumit Drin.
- Ështe mbajtur procesverbali , date 27.10.2025 mbi gjendjen e argjinatures.
- Drejtori ka nxjerrë urdhërin nr.87/1, dt.11.08.2025 për ngritjen e grupit të punës mbi verifikimin e objekteve te cilet kane nevojë per hartimin e projekteve te zbatimit.
 - Drejtori ka nxjerrë urdhërin nr.89, dt.15.08.2025 për ngritjen e grupit të punës mbi inspektimin e objekteve ku ushtron aktivitet DUK Lezhe .
 - Drejtori ka nxjerrë urdhërin nr.95, dt.15.09.2025 për ngritjen e grupit të punës per kontrollin e argjinaturave , Kanaleve te Ujerave te Larta dhe diges se rezervuarit Shtoder.
 - Ështe mbajtur procesverbali, date.1.10.2025 mbi gjendjen dhe gatishmerine e objekteve te mbrojtjes nga permbytja si me poshte :
 1. Argjinatura e Lumit Mat.
 2. Argjinatura e Lumit Drin
 3. Argjinatura e Lumit Gjader
 4. Argjinatura e Lumit Droje
 5. Argjinatura KUL Zejmen – Tresh.
 6. Argjinatura kufizimi me detin K-12 Ishull lezhe .
 7. Argjinatura Keneta Ishull Shengjin
 8. Argjinatura Bisht Juge
 9. Argjinatura e kanalit te Capit (Gocaj)
 10. Argjinatura KUL Zadrime

11. Argjinatura KUL Kurbin, Mamurras
12. Argjinatura KUL Shullaz
13. Argjinatura bregdetare Gotull
14. Argjinatura e rindertuar (derdhja e kanalit kullues K-K-1 , Kurbin)

Është mbajtur procesverbali , date 1.10.2025 mbi gjendjen dhe gatishmerine e objekteve te mbrojtjes nga permbytja si me poshte :

1. Argjinatura e Dajçit
2. Argjinatura e Darragjatit
3. Argjinatura e Çasit, Velipoje
4. Argjinatura Pentar-Luarez-Pulaj, Velipoje
5. Argjinatura Vilunit, Velipoje
6. Argjinatura Kuç - Vukatane
7. Argjinatura Suka – Mjede – Stajka
8. Argjinatura Kosmaç – Ashte
9. Argjinatura Naraç – Gjader
10. Argjinatura e Rrjollit , Bashkia Malesi e Madhe
11. Argjinatura Vermosh, Bashkia Malesi e Madhe .

- Drejtori ka nxjerrë urdhërin nr.108, dt.26.11.2025 për ngritjen e grupit të punës për kontrollin e argjinaturave , pas reshjeve intensive te rena.
- Drejtori ka nxjerrë urdhërin nr.108/1, dt.2.12.2025 për ngritjen e grupit të punës për mbi verifikimin ne vend te demtimit te metejshem te argjinatures ne kanalin K-II hidrovari Tale.

OBJEKTIVI NR. 4

" Mbajtja në gatishmëri teknike e stacioneve të pompimit të kullimit (hidrovolet)

- Bazuar në udhëzimin nr.12 dt.30.12.2019 pika 6.5.5.1 është bërë çdo ditë kontrolli i gjendjes së ndërtesës (vaskat në hyrje dhe në dalje, zgarat metalike , bazamentet ku bazohen pompat , kollonat, trarët e lëvizjes së vinçit , mbulesa e sipërme çedime në strukturën ndërtimore) .
- Bazuar në udhëzimin nr.12 dt.30.12.2019 pika 6.5.5.2 është bërë çdo ditë kontrolli i gatishmërisë teknike të elektromotorëve , pompave, pajisjeve elektrike të lëshimit , transformatorët , siguresat dhe çelësat e tensionit të mesëm,tokëzimi etj) .
- Punonjësit e shfrytëzimit të hidrovolet janë instruktuar dhe kanë kaluar testim për njohuritë e sigurimi teknik dhe mbrojtjes në punë duke u pajisur me dokumentacionin përkatës.
- Një herë në tremuaj Përgjegjësi i Sektorit Hidrovor makineri (inxhinier elektrik/mekanik,ka instruktuar ,kontrolluar njohuritë e punonjësve të hidrovolet mbi zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë.
- Punonjësit e hidrovolet janë pajisur dhe kanë mbajtur dhe plotësuar regjistrat e marrjes në dorëzim të turnit të punës sipas aneksit nr.2 të udhëzimi nr.12.

- Hidrovoret janë mbajtur në gatishmëri gjatë 24 orëve pa ndërprerje.
- Është bërë remonti vjetor në hidrovore dhe në përfundim të tij është bërë kolaodimi teknik .
- Ka funksionuar grupi i emergjencave për të menaxhuar situatën dhe për të bashkërenduar punën me Bashkitë dhe në dhënien e informacioneve të duhura pranë MBZHR .
- Drejtori ka nxjerrë urdhërin nr.89, dt.15.08.2025 për ngritjen e grupit të punës mbi inspektimin e objekteve ku ushtron aktivitet DUK Lezhe .

Forcimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion është shumë i rëndësishëm për një administratë efikase, transparente dhe të përgjegjshme në të gjitha nivelet. Në këtë drejtim, është synuar të garantohet një proces transparent për plotësimin e vendeve vakante, duke u mbështetur në parimet e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, profesionalizmit dhe paanësisë politike.

Gjithashtu nëpërmjet këtij objekti është synuar kryerja e trajnimeve të vazhdueshme me qëllim forcimin e integritetit të punonjësve, njohja me rregullat e etikës si dhe përmirësimi i njohurive të punonjësve, sipas fushës së veprimtarisë . Me qëllim përmbushjen e këtij objekti gjatë periudhës raportuese, janë realizuar masat si vijon:

Janë zhvilluar trajnime për legjislacionin tatimor, kryesisht në rastet e ndryshimeve ligjore dhe ligjeve të reja. Specialisti financiar ka marrë pjesë në trajnimet e realizuara mbi aspektet e reja të ligjit nr.29/2023 *"Për Tatimin mbi të Ardhurat"*, i ndryshuar. Në periudhën në vazhdim, do të vijohet me pjesëmarrjen në trajnime të tjera mbi legjislacionin tatimor.

Përgjegjësi i Sektorit të Financës ka marrë pjesë në trajnim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, ku gjatë viti 2025 janë zhvilluar trajnime :

1. Prokurimi Publik me vlerë të vogël.
2. Menaxhimi strategjik ne institucionet publike.
3. Afesite menaxheriale per zhvillimin e burimeve njerëzore.
4. Kriteret e veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike.
5. Programi buxhetor afatmesëm, formularët e konceptimit të projektit të investimit hapi i parë drejt një investimi publik të qendrueshëm.
6. Marrëdhëniet individuale të punës , të drejtat, detyrimet , përparësitë e normave juridike.
7. Procesi i vlerësimit të punës , në zbatim të ligjit për shërbimin civil.
8. Menaxhimi i stresit dhe pasigurisë.
9. Fazat e procedurës administrative, fillimi i procedurës dhe hetimi administrative.
10. Marreveshjet e fshehta në oferta.
11. Inteligjenca Emocionale.
12. Deklarimi i pasurive, llojet dhe afatet e deklarimit të pasurisë.
13. Vlerësimi, kontrolli dhe audit.
14. Transparenca dhe akses në informacionin publik.

Specialisti jurist ka marrë pjesë në të gjithë trajnimet e ofruara nga ASPA lidhur me prokurimet publike dhe trajnime të tjera në mbështetje të detyrave që kryen si më poshtë :

1.Prokurimi Publik

2.Prokurimi Publik

- 3.E drejta e informimit
- 4.Sistemi I prokurimit publik
5. Menaxhimi i stresit dhe pasigurisë
6. Inteligjenca Artificiale në Administratën Publike
7. Fazat e procedurës administrative, fillimi i procedurës dhe hetimi administrativ
8. Kriteret e vecanta për kualifikim dhe specifikimet teknike.
9. Marreveshjet e fshehta në ofertë
- 10.Inteligjenca Emocionale
- 11.Deklarimi i pasurive, llojet dhe afatet e deklarimit të pasurisë
- 12.Vlerësimi, kontrolli dhe audit
- 13.Mjetet ligjore të ankimit administrativ, pavlefshmëria absolute dhe paligjshmëria e aktit
- 14.Marrëdhëniet individuale të punës, të drejtat, detyrimet përparësitë e normave juridike

Punonjësi i Sekretari dhe Arkivës ka marrë pjesë në trajnimet si më poshtë :

1. Menaxhimi strategjik në institucionet publike.
2. Aftësitë menaxheriale për zhvillimin e burimeve njerëzore.
3. Marrëdhëniet individuale të punës , të drejtat, detyrimet , përparësitë e normave juridike.
4. Procesi i vlerësimit të punës , në zbatim të ligjit për shërbimin civil.
5. Menaxhimi i stresit dhe pasigurisë.
6. Inteligjenca Emocionale.
7. Deklarimi i pasurive, llojet dhe afatet e deklarimit të pasurisë.
8. Vlerësimi, kontrolli dhe audit.

Transparenca dhe akses

“Përmirësimi i kuadrit rregullator, me qëllim forcimin e integritetit në institucion”

Përmirësimi dhe rishikimi i vazhdueshëm i kuadrit rregullator ndikon në rritjen e efikasitetit, transparencës, llogaridhënies e besueshmërisë publike, si dhe arritjen e objektivave strategjike e specifike të institucionit.

Me qëllim realizimin e këtij objekti jemi pajisur me të gjithë VKM ,udhëzimet e reja .

- Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Mbi përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.
- Udhëzimin nr.13, datë 18.12.2024 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit të vitit 2024”.

Gjatë periudhës së raportimit jemi përditësuar me manualët mbi përdorimin e Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), në përshtatje me ndryshimet e legjislacionit në fuqi duke bërë të mundur lehtësimin e procedurave të punës me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ, si dhe përmirësimin e raportimit financiar për detyrimet e prapambetura.

V. KONKLUZIONE

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën janar-dhjetor 2025, rezulton se:

- DUK Lezhë ka vijuar me përmbushjen e masave të parashikuara në Planin e Integritetit.
- Krahasuar me vitet e kaluara, performanca institucionale e DUK Lezhë është në rritje.
- Janë realizuar trajnime të vazhdueshme me qëllim forcimin e integritetit të punonjësve, si dhe përmirësimin e njohurive të tyre, sipas fushës së veprimtarisë së institucionit.
- DUK Lezhë po vijon me angazhimin maksimal për realizimin e masave të tjera të parashikuara në plan, brenda afateve të caktuara.

DREJTORI

Nikolin Prendi

